

VENDIM
Nr. 717, datë 16.10.2012

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
TË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS FUSHË-KRUJË-URA E GJOLËS-TIRANË-
RROGOZHINË-KONJAT DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “KONSTRUKTOR-
INZENJERING D.D” SPLIT, KROACI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, e 23 pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion, të formës DFBOT (projektim-financim-ndërtim-shfrytëzim-transferim në pronësi të shtetit), të ndërtimit të autostradës Fushë-Krujë-Ura e Gjolës-Tiranë-Rrogozhinë-Konjat është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.
2. Miratimin e bonusit prej 9.1 pikësh, për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar) që i jepet shoqërisë “Konstruktor-Inzenjering d.d” Split, Kroaci.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha